VENDIM
Nr. 258, datë 27.4.2023

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, KRITEREVE, PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT DHE TË VENDIMMARRJES, FORMATIT DHE AFATEVE PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorimin civil", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Lëndët plasëse për përdorim civil përdoren vetëm me autorizim nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe çështjet minerare.

2. Autorizimi për përdorim civil të lëndëve plasëse u jepet:

a) operatorëve ekonomikë të pajisur me licencë/leje nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, hidrokarbure, energjetike dhe të infrastrukturës, të cilat për realizimin e veprimtarisë së tyre e kanë të domosdoshëm përdorimin e lëndëve plasëse. Ky autorizim është i vlefshëm vetëm brenda objektit të përcaktuar në licencën/lejen e veprimtarisë së operatorit ekonomik në momentin e marrjes së autorizimit;

b) subjekteve të kontraktuara nga operatorët ekonomikë të pajisur me licencë/leje, sipas shkronjës "a", të kësaj pike. Ky autorizim është i vlefshëm vetëm brenda koordinatave të përcaktuara në marrëveshjen kontraktore me operatorin ekonomik, në objektin për të cilin operatori ekonomik është i pajisur me licencë/leje në momentin e marrjes së autorizimit;

c) operatorëve ekonomikë të specializuar për përdorimin civil të lëndëve plasëse.

KREU II
KUSHTET DHE KRITERET E PAJISJES ME AUTORIZIM PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

Neni 2

1. Operatori ekonomik i pajisur me licencë/leje, që kërkon të pajiset me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë një person juridik i regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) të ketë në staf punonjës të aftë nga ana shëndetësore, të kualifikuar teknikisht dhe të trajnuar për kryerjen në mënyrë të sigurt për veprimtarinë e përdorimit të lëndëve plasëse, si dhe të pajisur me vërtetim besueshmërie;

c) të ketë kontratë sigurimi për punonjësit e angazhuar në punët me lëndë plasëse, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 1109, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë";

ç) të ketë të përcaktuar në kontratën e punës detyrat e punonjësve që do të angazhohen në përdorimin e lëndëve plasëse, të cilat duhet të jenë në zbatim të rregullores së teknikës së sigurimit për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

d) të vërtetojë se specialistët e huaj, që janë pjesë e stafit teknik, përveç plotësimit të kritereve të shkronjës "b", të kësaj pike, plotësojnë kriteret e punësimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt";

dh) të ketë autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose kontratë me një subjekt që ka autorizim për magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar. Kontrata verifikohet nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria;

e) të ketë program vjetor të kualifikimit të punonjësve, që merren me kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.

Neni 3

1. Subjekti i kontraktuar nga operatori ekonomik i pajisur me licencë/leje, që kërkon të pajiset me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë një person juridik i regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) të ketë kontratë nënkontraktimi me operatorin ekonomik, të pajisur me licencë/leje nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, hidrokarbure, energjetike dhe të infrastrukturës, i cili për realizimin e veprimtarisë së tij e ka të domosdoshëm përdorimin e lëndëve plasëse;

c) të ketë në staf punonjës të aftë nga ana shëndetësore, të kualifikuar teknikisht dhe të trajnuar për kryerjen në mënyrë të sigurt të veprimtarisë së përdorimit të lëndëve plasëse, si dhe të pajisur me vërtetim besueshmërie;

ç) të ketë kontratë sigurimi për punonjësit e angazhuar në punët me lëndë plasëse, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 1109, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë";

d) të ketë të përcaktuar në kontratën e punës detyrat e punonjësve që do të angazhohen në përdorimin e lëndëve plasëse, të cilat duhet të jenë në zbatim të rregullores së teknikës së sigurimit për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

dh) të vërtetojë se specialistët e huaj, që janë pjesë e stafit teknik, përveç plotësimit të kritereve të shkronjës "b", të kësaj pike, plotësojnë kriteret e punësimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt";

e) të ketë autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose kontratë me një subjekt që ka autorizim për magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar. Kontrata verifikohet nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria;

ë) të ketë program vjetor të kualifikimit të punonjësve, që merren me kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.

Neni 4

1. Operatori ekonomik i specializuar, që kërkon të pajiset me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë një person juridik i regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) të ketë personel inxhiniero-teknik, të aftë nga ana shëndetësore, të kualifikuar teknikisht dhe të trajnuar për kryerjen në mënyrë të sigurt të veprimtarisë së përdorimit të lëndëve plasëse, si dhe të pajisur me vërtetim besueshmërie;

c) të ketë pajisjet të certifikuara të kontrollit teknik dhe shpërthimit të ngarkesave me lëndë plasëse, si dhe pajisjet e certifikuara për matjet e gazeve;

ç) të ketë kontratë sigurimi për punonjësit e angazhuar në punët me lëndë plasëse, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 1109, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë";

d) të ketë të përcaktuar në kontratën e punës detyrat e punonjësve që do të angazhohen në përdorimin e lëndëve plasëse, të cilat duhet të jenë në zbatim të rregullores së teknikës së sigurimit për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

dh) të vërtetojë se specialistët e huaj, që janë pjesë e stafit teknik, përveç plotësimit të shkronjës "b", të kësaj pike, plotësojnë kriteret e punësimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt";

e) të ketë autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose kontratë me një subjekt që ka autorizim për magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar. Kontrata verifikohet nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria.

KREU III
DOKUMENTACIONI PËR APLIKIMIN PËR PAJISJE ME AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

Neni 5

1. Dokumentacioni për plotësimin e kritereve për pajisje me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse për operatorët ekonomikë të pajisur me licence/leje është, si më poshtë vijon:

a) kërkesa e aplikimit, e cila duhet të përmbajë emrin dhe adresën e selisë së operatorit ekonomik, adresën e vendit ku do të kryhet veprimtaria e lëndëve plasëse, si dhe të dhënat e personave që do të angazhohen në përdorimin e tyre;

b) licenca/leja e lëshuar nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, hidrokarbure, energjetike dhe të ndërtimit (infrastrukturës);

c) ekstrakti historik i regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

ç) dokumentacioni, ku vërtetohet se operatori ekonomik ka magazinë për lëndët plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose kontratë me një subjekt që ka autorizim për magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar. Kontrata duhet të jetë e verifikuar nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria;

d) vërtetimi i regjistrimit në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera;

dh) projekti i kryerjes së punëve me lëndë plasëse, në zbatim të projektit të miratuar për objektin ku do të kryhet veprimtaria e licencuar/lejuar nga institucionet përkatëse, i cili duhet të jetë në zbatim të rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse;

e) njoftimi tek organet e pushtetit vendor për sipërfaqen e rrezikshme ku do të kryhet veprimtaria me lëndë plasëse;

ë) programi vjetor i kualifikimit të punonjësve, që merret me kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.

2. Dokumentacioni që operatorët ekonomikë të pajisur me licence/leje paraqesin për punonjësit, që do të angazhohen në punën me lëndë plasëse, është, si më poshtë vijon:

a) kopja e dokumentit të identifikimit;

b) vërtetim i gjendjes shëndetësore, lëshuar nga organi kompetent pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetin publik;

c) dëshmia e trajnimit të kualifikimit teknik për punën me lëndë plasëse të punonjësve, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për industrinë minerare;

ç) vërtetimi i besueshmërisë i lëshuar nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon rendin dhe sigurinë;

d) kontrata e punës me inxhinier ose teknik të certifikuar, si drejtues teknik për veprimtarinë minerare ose për veprimtarinë e hapjes së punimeve minerale kapitale dhe dytësore, tuneleve dhe punimeve kapitale nëntokësore për infrastrukturën rrugore, hidrocentrale, kur veprimtaria do të kryhet në objekte minerare, tunele, infrastrukturë rrugore apo hidrocentrale.

Kontrata e punës me ekspertë të certifikuar, si drejtues teknik për aktivitetin e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure, kur veprimtaria do të kryhet për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në blloqet e kërkimit apo në vendburimet ekzistuese hidrokarbure.

Kontrata e punës me drejtuesin teknik të certifikuar, me profesion inxhinier ndërtimi, inxhinier gjeolog, oficer xhenier, oficer EOD, në veprimtaritë e tjera sipërfaqësore;

dh) kopja e certifikatës profesionale të drejtuesit teknik;

e) kontrata e punës me zjarrmëtarin, si dhe kopje të dëshmisë së zjarrmëtarit;

ë) kontrata për sigurimin nga aksidentet në punë për personat e angazhuar në veprimtarinë e punëve me lëndët plasëse;

f) kopja e lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj;

g) vërtetimi nga njësia vendore për vendbanimin për shtetasit e huaj.

Neni 6

1. Dokumentacioni për plotësimin e kritereve për pajisje me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse për subjektet e kontraktuara nga operatorët ekonomikë të pajisur me licence/leje është, si më poshtë vijon:

a) kërkesa e aplikimit, e cila duhet të përmbajë emrin dhe adresën e subjektit të kontraktuar, emrin e operatorit ekonomik të licencuar, adresën e vendit ku do të kryhet veprimtaria e lëndëve plasëse, si dhe të dhënat e personave që do të angazhohen në përdorimin e tyre;

b) kontrata e noterizuar, ndërmjet subjektit të kontraktuar dhe operatorit ekonomik, për objektin ku operatori ekonomik është pajisur me licence/leje;

c) licenca/leja e operatorit ekonomik, e lëshuar nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, hidrokarbure, energjetike dhe të infrastrukturës;

ç) ekstrakti historik i regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit të subjektit të kontraktuar;

d) dokumentacioni, ku vërtetohet se operatori ekonomik ka magazinë për lëndët plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ose kontratë me një subjekt që ka autorizim për magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar. Kontrata duhet të jetë e verifikuar nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria;

dh) vërtetimi i regjistrimit në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, për subjektin e kontraktuar;

e) projekti i kryerjes së punëve me lëndë plasëse, në zbatim të projektit të miratuar për objektin ku do të kryhet veprimtaria e licencuar/lejuar nga institucionet përkatëse, i cili duhet të jetë në zbatim të rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse;

ë) njoftimi tek organet e pushtetit vendor për sipërfaqen e rrezikshme, ku do të kryhet veprimtaria me lëndë plasëse;

f) programi vjetor i kualifikimit të punonjësve që merren me kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.

2. Dokumentacioni që subjektet e kontraktuara nga operatorët ekonomikë të pajisur me licence/leje paraqesin për punonjësit që do të angazhohen në punën me lëndë plasëse është, si më poshtë vijon:

a) kopja e dokumentit të identifikimit;

b) vërtetimi i gjendjes shëndetësore, lëshuar nga organi kompetent pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetin publik;

c) dëshmia e trajnimit të kualifikimit teknik për punën me lëndë plasëse të punonjësve, e lëshuar nga ministria përgjegjëse për industrinë minerare;

ç) vërtetimi i besueshmërisë, lëshuar nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon rendin dhe sigurinë;

d) kontrata e punës me inxhinier ose teknik të certifikuar si drejtues teknik për veprimtarinë minerare ose për veprimtarinë e hapjes së punimeve minerale kapitale dhe dytësore, tuneleve dhe

punimeve kapitale nëntokësore për infrastrukturën rrugore, hidrocentrale, kur veprimtaria do të kryhet në objekte minerare, tunele, infrastrukturë rrugore apo hidrocentrale.

Kontrata e punës me ekspertë të certifikuar si drejtues teknik për aktivitetin e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure, kur veprimtaria do të kryhet për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në blloqet e kërkimit apo në vendburimet ekzistuese hidrokarbure.

Kontrata e punës me drejtuesin teknik të certifikuar, me profesion inxhinier ndërtimi, inxhinier gjeolog, oficer xhenier, oficer EOD në veprimtaritë e tjera sipërfaqësore;

dh) kopja e certifikatës profesionale të drejtuesit teknik;

e) kontrata e punës me zjarrmëtarin, si dhe kopje të dëshmisë së zjarrmëtarit;

ë) kontrata për sigurimin nga aksidentet në punë për personat e angazhuar në veprimtarinë e punëve me lëndët plasëse;

f) kopja e lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj;

g) vërtetimi nga njësia vendore për vendbanimin për shtetasit e huaj.

Neni 7

1. Dokumentacioni për plotësimin e kritereve për pajisje me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse për operatorët ekonomikë të specializuar është, si më poshtë vijon:

a) kërkesa e aplikimit, e cila duhet të përmbajë emrin dhe adresën e operatorit ekonomik të specializuar, veprimtaritë për të cilat kërkon të pajiset me autorizim, si operator i specializuar për lëndët plasëse, dhe të dhënat e personave që do të angazhohen në përdorimin e tyre;

b) ekstrakti historik i regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

c) informacioni me të dhënat e përgjithshme për personelin inxhiniero-teknik për njohuritë e veprimtarinë e tyre të mëparshme në aktivitetin minerar në tërësi, e veçanërisht, në punët me lëndët plasëse;

ç) dokumentacioni, ku vërtetohet se operatori ekonomik ka magazinë për lëndët plasëse për përdorim civil, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose kontratë me një subjekt që ka autorizim për magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar. Kontrata duhet të jetë e verifikuar nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku kryhet veprimtaria;

d) dokumentacioni për disponimin e pajisjeve të certifikuara të kontrollit teknik dhe shpërthimit të ngarkesave me lëndë plasëse, si dhe pajisjet e certifikuara për matjet e gazeve;

dh) pasaportat tip të kryerjes së punëve me lëndë plasëse për të gjitha llojet e punimeve nëntokësore e sipërfaqësore së bashku me metodikën e llogaritjeve të treguesve teknologjik;

e) projekti tip i kryerjes së punëve me lëndë plasëse për të gjitha llojet e punimeve nëntokësore e sipërfaqësore, ku të përcaktohen edhe largësitë e parrezikshme për mbrojtjen e njerëzve dhe të objekteve të ndryshme nga lëkundjet sizmike dhe nga vala goditëse, si dhe flakjen e gurëve apo sendeve të tjera të shkaktuara nga shpërthimi, së bashku me metodikën e llogaritjeve të këtyre treguesve;

ë) programi vjetor i kualifikimit të punonjësve, që merren me kryerjen e punimeve me lëndë plasëse.

2. Dokumentacioni që operatorët ekonomikë të specializuar paraqesin për punonjësit, që do të angazhohen në punën me lëndë plasëse është, si më poshtë vijon:

a) kopja e dokumentit të identifikimit;

b) vërtetimi i gjendjes shëndetësore, lëshuar nga organi kompetent pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetin publik;

c) dëshmia e trajnimit të kualifikimit teknik për punën me lëndë plasëse të punonjësve, e lëshuar nga ministria përgjegjëse për industrinë minerare;

ç) vërtetimi i besueshmërisë, të lëshuar nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon rendin dhe sigurinë;

d) kontrata e punës me inxhinier ose teknik të certifikuar si drejtues teknik për veprimtarinë minerare ose për veprimtarinë e hapjes së punimeve minerale kapitale dhe dytësore, tuneleve dhe

punimeve kapitale nëntokësore për infrastrukturën rrugore, hidrocentrale, kur veprimtaria do të kryhet në objekte minerare, tunele, infrastrukturë rrugore apo hidrocentrale.

Kontrata e punës me ekspertë të certifikuar si drejtues teknik për aktivitetin e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure, kur veprimtaria do të kryhet për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në blloqet e kërkimit apo në vendburimet ekzistuese hidrokarbure.

Kontrata e punës me drejtuesin teknik të certifikuar, me profesion inxhinier ndërtimi, inxhinier gjeolog, oficer xhenier, oficer EOD, në veprimtaritë e tjera sipërfaqësore;

dh) kopja e certifikatës profesionale të drejtuesit/ve teknikë;

e) kontrata e punës me zjarrmëtarin/ët, si dhe kopja e dëshmisë së zjarrmëtarit/ëve;

ë) kontrata për sigurimin nga aksidentet në punë për personat e angazhuar në veprimtarinë e punëve me lëndët plasëse;

f) kopja e lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj;

g) vërtetimi nga njësia vendore për vendbanimin për shtetasit e huaj.

KREU IV
PROCEDURAT, AFATET, VLEFSHMËRITË DHE FORMATET PËR APLIKIMIN DHE DHËNIEN E AUTORIZIMEVE PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

Neni 8

1. Operatori ekonomik aplikon për autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet minerare dhe energjinë nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*".

2. Drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet minerare dhe energjinë verifikon dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik, përgatit kërkesën për verifikimin e besueshmërisë së personave që do të angazhohen në punët me lëndët plasëse, si dhe dërgon projektin e kryerjes së punëve me lëndë plasëse në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.

Neni 9

1. Afati i përgjithshëm për shqyrtimin e aplikimit për pajisjen me autorizim është jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga plotësimi i dokumentacionit të plotë.

2. Në rastet kur konstatohen mangësi në kërkesën për aplikim apo mungesë të dokumentacionit, njoftohet operatori ekonomik për plotësimin e tyre. Operatori ekonomik brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të plotësojë mangësitë e konstatuara. Afati i shqyrtimit pezullohet deri në plotësimin e mangësive të kërkesës nga operatori ekonomik.

3. Në rast se edhe pas kalimit të afatit 10-ditor (dhjetëditor) operatori ekonomik nuk plotëson mangësitë e konstatuara, kërkesa për pajisjen me autorizim nuk do të pranohet.

Neni 10

Operatorit ekonomik i dërgohet vendimi i miratimit apo i mospranimit në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete që ka aplikuar.

Neni 11

1. Afati i vlefshmërisë së autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse i operatorëve ekonomikë, të pajisur me licencë/leje nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, hidrokarbure, energjetike dhe të infrastrukturës, të cilat për realizimin e veprimtarisë së tyre e kanë të domosdoshëm përdorimin e lëndëve plasëse, është i njëjtë me afatin e licencës/lejes për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Autorizimi për përdorim civil të lëndëve plasëse është i vlefshëm vetëm brenda sipërfaqes, për të cilën është licencuar/lejuar operatori ekonomik për të ushtruar veprimtarinë. Në rast të ndryshimit të sipërfaqes së licencuar/lejuar, operatorët ekonomikë të pajisur me licencë/leje duhet të aplikojnë për një autorizim të ri për përdorim civil të lëndëve plasëse, me një projekt sipas sipërfaqes së rikonfiguruar.

3. Afati i vlefshmërisë së autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse i subjekteve të kontraktuara nga operatorët ekonomikë të pajisur me licence/leje sipas fushave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, është i njëjtë me afatin e kontratës së nënshkruar nga palët.

4. Afati i autorizimit të operatorëve ekonomikë të specializuar për përdorimin civil të lëndëve plasëse është 10 (dhjetë) vjet. Operatorët ekonomikë të specializuar paraqesin çdo vit pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera informacion të hollësishëm për zhvillimin e veprimtarisë me lëndë plasëse. Përmbajtja e këtij informacioni përcaktohet në aneksin 2, të këtij vendimi.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga pajisja me autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse si subjekt i specializuar, operatori ekonomik duhet të kryejë regjistrimin në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.

Neni 12

1. Operatori ekonomik i specializuar, i autorizuar për përdorimin civil të lëndëve plasëse, mund të lidhë kontratë për kryerjen e punimeve me lëndë plasëse për përdorim civil me operatorët ekonomikë të pajisur me licencë/leje nga institucionet përkatëse në fushat minerare, gjeologjike, hidrokarbure, energjetike dhe infrastrukturës, të cilët nuk kanë autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse, por e kanë të parashikuar përdorimin e lëndëve plasëse në projektin e miratuar për objektin. Për këto raste, veprohet, si më poshtë vijon:

a) Kontratës për kryerjen e punëve me lëndë plasëse i bashkëlidhen projekti i kryerjes së punëve me lëndë plasëse, në zbatim të projektit të miratuar për objektin ku do të kryhet veprimtaria e licencuar/lejuar nga institucionet përkatëse, njoftimi drejtuar organeve të pushtetit vendor për sipërfaqen e zonës së rrezikshme ku do të kryhet veprimtaria me lëndë plasëse, si dhe vërtetimi që subjekti disponon magazinë të miratuar të lëndëve plasëse ose kontratë me një subjekt që ka magazinë të lëndëve plasëse, të miratuar;

b) Para fillimit të punimeve, subjekti i specializuar, i autorizuar, që ka lidhur një kontratë, njofton Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera;

c) Për çdo kontratë me operatorë të tjerë ekonomikë, subjekti i specializuar duhet të miratojë në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera projektin e kryerjes së punëve me lëndë plasëse, në zbatim të projektit të miratuar për objektin ku do të kryhet veprimtaria e licencuar/lejuar nga institucionet përkatëse.

Neni 13

1. Kontrolli për përdorimin civil të lëndëve plasëse bëhet nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe institucionet e tjera të specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj.

Autorizimi për përdorim civil të lëndëve plasëse, shfuqizohet, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 22, "Kushtet e përgjithshme të administrimit", të ligjit nr. 74/2021.

2. Formati i autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse është sipas aneksit 1, të këtij vendimi.

3. Operatori ekonomik duhet të aplikojë për ndryshim të autorizimit, në rast të ndryshimit të personave që do të angazhohen në punën me lëndë plasëse. Për çdo person të ri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

1. Vendimi nr. 315, datë 5.5.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurën e dhënies së autorizimit, për përdorimin civil të lëndëve plasëse", shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe institucionet e tjera të specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj, për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 15

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



ANEKSI I
FORMATET E AUTORIZIMEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

A U T O R I Z I M

PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

NR. .....

Mbështetur në ligjin nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorimin civil", si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr....., jepet ky autorizim:

Në objektin: (emri i objektit ku do të kryhet aktivitet me lëndë plasëse).

Licenca/ Leja/Kontrata: (të dhënat për licencën/lejen/kontratën)

Operatori ekonomik: (emri i personit juridik)
Administratori: (emri i administratorit)
Drejtuesi teknik: (emri i drejtuesit teknik)
Selia e shoqërisë: (adresa e operatorit ekonomik)

Afati i vlefshmërisë së autorizimit është i njëjtë me afatin e vlefshmërisë së licencës/lejes për të cilën operatori ekonomik është licencuar

ose

Afati i autorizimit është i njëjtë me afatin e e vlefshmërisë së licencës/lejes/kontratës, për të cilën operatori ekonomik është kontraktuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

A U T O R I Z I M

PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

NR. .....

Mbështetur në ligjin nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorimin civil", si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr....., jepet ky autorizim:

Subjekt i specializuar për: - miniera
- hidrokarbure
- infrastrukture

Operatori ekonomik: (emri i personit juridik)
Administratori: (emri i administratorit)
Drejtuesi teknik: (emri i drejtuesit teknik)
Selia e shoqërisë: (adresa e operatorit ekonomik)

Afati i vlefshmërisë së autorizimit është 10 (dhjetë) vjet.

MINISTRI



ANEKSI 1
FORMATET E AUTORIZIMEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

AUTORIZIM
PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE
NR. .....

Mbështetur në ligjin nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorimin civil", si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr....., jepet ky autorizim:

Në objektin: (emri i objektit ku do të kryhet aktivitet me lëndë plasëse).

Licenca/ Leja/Kontrata: (të dhënat për licencën/lejen/kontratën)

Operatori ekonomik: (emri i personit juridik)
Administratori: (emri i administratorit)
Drejtuesi teknik: (emri i drejtuesit teknik)
Selia e shoqërisë: (adresa e operatorit ekonomik)

Afati i vlefshmërisë së autorizimit është i njëjtë me afatin e vlefshmërisë së licencës/lejes për të cilën operatori ekonomik është licencuar

ose

Afati i autorizimit është i njëjtë me afatin e e vlefshmërisë së licencës/lejes/kontratës, për të cilën operatori ekonomik është kontraktuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

AUTORIZIM
PËR PËRDORIM CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE
NR. .....

Mbështetur në ligjin nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorimin civil", si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr....., jepet ky autorizim:

Subjekt i specializuar për: - miniera
- hidrokarbure
- infrastrukture

Operatori ekonomik: (emri i personit juridik)
Administratori: (emri i administratorit)
Drejtuesi teknik: (emri i drejtuesit teknik)
Selia e shoqërisë: (adresa e operatorit ekonomik)

Afati i vlefshmërisë së autorizimit është 10 (dhjetë) vjet.

MINISTRI

ANEKSI 2

INFORMACIONI VJETOR I SUBJEKTEVE TË SPECIALIZUARA NË PËRDORIMIN CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE

Subjektet e specializuara paraqesin në Agjencinë Kombëtare për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera informacion të hollësishëm për aktivitetin me lëndë plasëse, çdo vit deri më 20 janar të vitit pasardhës, me këtë përmbajtje:

a) Relacion përshkrimor për të gjithë veprimtarinë e punës me lëndë plasëse, të kryer gjatë vitit paraardhës, së bashku me projektet teknike, të miratuara për çdo punim që ka kryer;

b) Për çdo subjekt ku ka kryer punime me lëndë plasëse, kontratat dhe realizimi i tyre të konfirmuar nga subjektet kontraktuese;

c) Evidencë e përdorimit të lëndëve e materialeve plasëse, të konfirmuara nga depot përkatëse të ruajtjes e furnizimit me lëndë plasëse;

ç) Informacion për personelin që ka punuar në punët me lëndë plasëse për çdo kontratë;

d) Tabelën e evidentimit të përdorimit të lëndeve e materialeve plasëse, sipas formatit të mëposhtëm.

Nr.	Emri i subjektit kontraktues	Objekti	Data e fillimit te punes ne objekt	Data e mbarimit te punes ne objekt	Volumi i punes se kryer ne ml/m3	Sasia e lendeve plasese se perdorur	Sasia e materialeve plasese	Depoja e lendeve plasese nga eshte bere furnizimi
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								